



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 171, datë 21.12.2012**

**PËR**

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “POSTA SHQIPTARE” SH.A. SI AGJENT NË  
SIGURIME TË JO-JETËS DHE AGJENTËVE PËR LLOGARI TË SAJ**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6, shkronja dh, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të nenit 81, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” dhe të VKM-së nr. 79, datë 28.01.2008 “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Licencimin e shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a. si agjent në sigurime të Jo-Jetës në emër dhe për llogari të shoqërisë “Insig” sh.a.
2. Licencimin e agjentëve në sigurime të Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a., sipas tabelës bashkëngjitur.
3. Licenca jepet me afat 3 vjet.
4. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Enkeleda SHEHI**